



Njësia i Prokurimit

Istog: datë, **18.04.2019**

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Istogut, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 15.04.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik ER-LIS SHPK & EING COM SHPK, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **LOTO 1 - SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL**, me Nr. të Prok: 633-19-426-2-2-1 nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik ER-LIS SHPK & EING COM SHPK, të dt. 15.04.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit **LOTO 1 - SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL**, me Nr. 633-19-426-2-2-1 Nr. Brendshëm 633-019-005-221, kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK –së, të datës 10.04.2019 të publikuar në web-faqe të E-prokurimit.
2. ***Vërtetohet*** vendimi i AK i publikuar me datë: 10.04.2019;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit*;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik ER-LIS SHPK & EING COM SHPK, me datë 15.04.2019, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **LOTO 1 - SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL**, me Nr. të Prok: 633-19-426-2-2-1; me Nr. të brendshëm të prokurimit: 633-019-005-221. Autoriteti Kontraktues, me datë **18.04.2019**, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Tenderi i juaj është administrativisht e papërgjegjshme:

-Autorizimi i kompanive që paraqiten në konzercium ka gabime pasi kompanite bashkepunuese janë: ER-LISI @ EING COM, ndërsa të Autorizimi ceket ER-LISI @VE-MOR".

Ky gabim për AK-në është i madhe dhe jo teknik sepse nuk ka gabime të vogla por në autorizim është i shkruar një emër i një firme tjetër.

-Poashtu në sistemin e e-prokurimit ka cmimin e njëjtit si me TVSH-e ashtu edhe pa TVSH-e-(deshmi edhe Procesverbali i hapjes).

Procesverbali i hapjes është ngritur në sistem të e-prokurimit, dhe nuk kemi pas kërkesë nga asnjë o.e. konkurrenës për procesverbal të hapjes.

Gjate ngritjes së ofertës tuaj në platformën e e-prokurimit, ju si o.e.konkurrenës nuk e keni ndarë vlerën e tvsh-se, ndërsa të gjithë operatorët e tjerë ekonomikë e kanë bërë një ndarje të tillë - e cila kërkohej në sistem të e-prokurimit. dhe juve si o.e. ju ka dalë në proces të hapjes cmimi i njëjtit si me tvsh - si pa tvsh.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit